



Dhikret e pasakta – Kategoritë e tyre

الحمد لله و صلى الله و سلم على نبينا محمد .أما بعد

Dhikret e mëngjesit dhe të mbrëmjes janë disa dhikre dhe dua, të cilat i ka thënë Profeti -sal-lall-llahu alejhi ue sel-lem-, ose ka nxitur për thënien e tyre në mëngjes dhe mbrëmje.

Prej tyre:

- Ka që janë të sakta në aspektin e transmetimit.
- Ka që nuk janë të sakta (janë të dobëta) në aspektin e transmetimit.

Si dhe prej tyre ka që dijetarët janë në mospajtim rreth saktësisë së tyre:

- Disa dijetarë i konsiderojnë të sakta.
- Disa të tjerë i konsiderojnë ato jo të sakta (të dobëta).

Në lidhje me këtë (dmth: kur ka mospajtim), përzgjedhim mendimin e shejh Albanit (All-llahu e mëshiroftë) duke qenë se ai është njeriu më i ditur i kohëve të fundit në njohjen e haditheve të sakta dhe të dobëta. Nëse nuk gjejmë gjykim të shejhut në një hadith, atëherë i referohemi të tjerëve.

Sa i përket dhikreve jo të sakta të mëngjesit dhe mbrëmjes, ato ndahen në tre kategori.

1) Kategoria e parë:

Dhikër i cili është i saktë, por që thuhet vetëm në mëngjes. Ndërsa thënia e tij në mbrëmje është e pasaktë. Si dhe kufizimi i tij në tre herë është i pasaktë.

Për shembull dhikri:

((Radijtu bil-lahi Rabben, ue bil Islami dīnen, ue bi Muhammedin -sal-lall-llahu alejhi ue sel-lem- nebijjen))

Ky dhikër është i saktë, por ka mospajtim në lidhje me shtesën në hadith e cila përmend veçimin dhe kufizimin e tij në mëngjes dhe mbrëmje, si dhe thënien tre herë.

Më e sakta është se thënia e këtij dhikri është saktësuar vetëm në mëngjes, dhe jo në mbrëmje. Thuhet një herë, dhe jo tre herë.

2) Kategoria e dytë:

Dhikër i cili është i saktë si dhikër, por kufizimi i tij në mëngjes dhe mbrëmje, si dhe në numër të caktuar nuk është i saktë.

Për shembull dhikri:

((Subhanall-Ilahi ue bihamdihi, adede khalkih, ue ridā nefsih, ue zinete arshih, ue mideede kelimetih))

Ky dhikër është i saktë [e transmeton Muslimi], por, kufizimi i tij në kohën e mëngjesit nuk përmendet në hadith, dmth: nuk përmendet se Profeti -sal-lall-Ilahu alejhi ue sel-lem- e ka thënë këtë në mëngjes, apo ka thënë që të thuhet në mëngjes.

Prandaj shumë prej dijetarëve të cilët e përmendin këtë dhikër në kapitull të veçantë, nuk përmendin kufizim të tij në një kohë të caktuar. Për shembull:

- Ibn Khuzejme -All-Ilahu e mëshiroftë- në [Sahihun e tij 1/370] e ka vendosur këtë dhikër në një kapitull (temë) të veçantë, dhe nuk përmend kufizim të tij në kohën e mëngjesit dhe të mbrëmjes.
- Po ashtu, Ibn Hibban -All-Ilahu e mëshiroftë- në [Sahihun e tij 3/114] e vendos këtë dhikër në kapitull të veçantë, dhe nuk përmend kufizim të thënjes së këtij dhikri në mëngjes dhe mbrëmje.
- Po ashtu, El Bejhakui -All-Ilahu e mëshiroftë- në [Shuab el Iman 2/50] e vendos këtë dhikër në temë të veçantë, dhe nuk përmend veçim dhe kufizim të këtij dhikri në mëngjes dhe mbrëmje.
- Po ashtu Bin Bazi në [Mexhmu Fetewa Ibn Baz 11/212] nuk e kufizon në kohë të veçantë. Thotë -Rahimehull-Ilah-:
وهكذا يستحب للمسلم أن يقول ((سبحان الله العظيم و بحمده عدد خلقه، سبحان الله رضى نفسه، سبحان الله زنة عرشه، سبحان الله مداد كلماته)) (ثلاث مرات [فلها شأن عظيم
"Pëlqehet që muslimani të thotë:
((Subhanall-Ilahi el Adhim ue bihamdihi adede khalkih, Subhanall-Ilahi ridā nefsih, Subhanall-Ilahi zinete arshih, Subhanall-Ilahi mideede kelimetih)) [tre herë];
sepse (ky dhikër) ka pozitë dhe rëndësi të madhe." -F-
Shejhu nuk e veçon dhe as nuk e kufizon me kohë të veçantë.

Më e sakta është se ky dhikër thuhet në çdo kohë, por thënia e tij në fillimin e ditës para lindjes diellit (në mëngjes), apo pas lindjes së diellit, [tre herë], është më parësore se sa në kohët tjera, duke u bazuar në veprimin e Profetit -sal-lall-Ilahu alejhi ue sel-lem- i cili transmetohet se e ka thënë këtë në fillim të ditës, dhe e ka thënë tre herë.

3) Kategoria e tretë:

Dhikër i cili nuk është i saktë fare, qoftë në aspektin e kufizuar dhe të veçantë në kohë, qoftë në aspektin e përgjithshëm, të pakufizuar.

All-Ilahu e di më së miri

و صلى الله على نبينا محمد وعلى آله وصحبه و سلم